



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2632 Prot.

Tiranë, më 26.02 2018

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve Kontraktore

Ashtu sikurse jeni në dijeni, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), me rekomandimin Nr. 2243 Prot., datë 16.02.2018 ka rekomanduar autoritetet kontraktore të kryejnë një planifikim të saktë të nevojave të tyre, pasi ndryshimi i regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik lejohet vetëm në raste të justifikuara, për të cilat autoritetet kontraktore nuk kanë pasur mundësi objektive për t'i planifikuar në kohën e krijimit të regjistrit.

Nisur nga pyetjet e shpeshta të autoriteteve kontraktore për përkufizimin e saktë të planifikimit të kohës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, APP ju bën me dije se, për të gjitha procedurat e prokurimit publik, autoritetet kontraktore nëse përcaktojnë si periudhë kohore të zhvillimit të tyre në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, muajin **Shtator**, atëherë duhet ta kryejnë procedurën e prokurimit **brenda muajit Shtator**, pa qenë e nevojshme të kryhen ndryshime në regjistër.

Sa i takon **procedurave të prokurimit me vlerë të vogël**, dhe **procedurave të prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar nëpërmjet Sistemit të thjeshtuar Dinamik të Blerjes**, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë si periudhë kohore të zhvillimit të procedurës së prokurimit në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, muajin **Dhjetor** të vitit kalendarik, me qëllim që të ketë mundësi të prokurojë gjatë gjithë vitit, për shkak edhe të natyrës së veçantë të këtyre procedurave të prokurimit, të cilat mund të realizohen disa herë brenda vitit kalendarik.

Pra, shtrirja e periudhës kohore gjatë të cilës mund të prokurohet nëpërmjet prokurimit me vlerë të vogël dhe Sistemit të thjeshtuar Dinamik të Blerjes do të jetë gjatë gjithë vitit kalendarik, sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

